



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republik of Kosova  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva**

## **ZYRA E KRYETARIT**

**Nr.02-112/13-31152/20  
Podujevë,  
Më:26.06.2020**

### **SHPALLJE PUBLIKE**

**Për angazhimin e punëtorëve me marrëveshje për shërbime të veçanta  
(Procedurë e thjeshtësuar e rekrutimit)**

Komuna e Podujevës duke u bazuar në Ligjin mbi marrëdhëniet e detyrimeve, Nr. 04/L-077, Neni 615, Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Neni 12, paragrafi 4 si dhe kërkesës së Drejtorive, të cilët përmes; Marrëveshjeve për Shërbime të Veçanta kërkojnë angazhimin e punëtorëve për ofrimin e shërbimeve të veçanta për nevojat e Drejtorive.

**Kohëzgjatja e Marrëveshjeve për Shërbimeve të veçanta është 6 (gjashtë) muaj.**

#### **1.Drejtoria e Inspeksionit**

**Titulli i vendit të punës: Inspektor Sanitar - Një (1) pozitë**

**Paga: 423.85 Euro Bruto**

**Kualifikimi: Diplomë Universiteti në këto fusha - Mjekësisë Sanitare, Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore**

#### **Detyrat e Punës**

1. Mbikëqyrë zbatimin e dispozitave ligjore dhe rregulloreve nga personat fizikë dhe juridikë, që kanë të bëjnë me fushën e shëndetit publik duke përfshirë në radhë të parë inspektimin dhe kontrollimin sanitar të lokaleve afariste-hoteliere në territorin e Komunës së Podujevës;
2. Kryen inspektimin e mallrave, barërave, ujit dhe gjendjen shëndetësore të personelit, që punojnë në lokale afariste-hoteliere me qëllim të parandalimit të sëmundjeve ngjitëse;
3. Harton procesverbalet nga inspektimi i objekteve duke përfshirë edhe palët;
4. Aplikon fletëparaqitjet për kundërvajtje;
5. Lëshon urdhëresa dhe ndalesa të përkohshme sipas rregullativës ligjore;
6. Propozon masat e sigurisë për konfiskimin e mallit duke përfshirë edhe ndërmarrjen e masave të sigurisë për mbylljen e lokaleve;
7. Përgatitë materiale, analiza dhe raporte si dhe bën sugjerime para mbikëqyrësit për përmirësimin e aspekteve të punës në zyrën ligjore;
8. Merr pjesë në komisione kur ngarkohet, kryen detyrat përkatëse si dhe detyra të tjera që mund ti ngarkohen nga mbikëqyrësi në përshtatje me natyrën e punës dhe profesionit të tij.

## **2.Drejtoria e Inspeksionit**

**Titulli i vendit të punës: Inxhinier Ndërtimi ose Arkitekturës - Një (1) pozitë**

**Paga: 423.85 Euro Bruto**

**Kualifikimi : Diplomë Universitare, Fakulteti i Ndërtimtarisë ose Arkitekturës**

### **Detyrat e punës:**

1. Të kontrollojë produktet ndërtimore, pajisjet, aparatet, repromaterialin për prodhim, përpunim dhe finalizim, si dhe prodhimet në të gjitha fazat e prodhimit dhe në të gjitha vendet ku gjenden dhe dokumentacionin tjetër përkatës të nevojshëm më qellim të mbikëqyrjes së zbatimit të dispozitave ligjore;
2. Merr pjesë në inspektimin e objektet ndërtimore për të verifikuar dokumentacionin e nevojshëm rreth ndërtimit të objektit sidomos për leje ndërtimore;
3. Të hyjë në çdo kohë gjatë orarit të punës, në prani të drejtuesit apo përfaqësuesit të tij, në reparte, linja prodhimi e shfrytëzimi dhe qendra tregtimi ku ushtrojnë veprimtari subjektet e përshkuara me ligj;
4. Mbikëqyr punën e pjesëmarrësve në ndërtimin, modifikimin, përdorimin, mirëmbajtjen dhe rrënimin e ndërtesave, si dhe cilësisë së përdorimit të produkteve të ndërtimit;
5. Kujdeset për aplikimin e fletëparaqitjeve për kundërvajtje;
6. Lëshon urdhëresa dhe ndalesa të përkohshme sipas rregullave ligjore për evitimin e parregullsive apo të mungesave gjatë kryerjes së punëve për një afat të caktuar kohor;
7. Ndërmerr masat e sigurisë për ndalimin e ndërtimeve pa leje;
8. Merr pjesë në komisione kur ngarkohet, kryen detyrat përkatëse si dhe detyra të tjera që mund t'i ngarkohen nga mbikëqyrësi në përshtatje me natyrën e punës dhe profesionit të tij.

## **3.Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural**

**Titulli i vendit të punës: Zyrtar për Bujqësi - Një (1) pozitë**

**Paga: 362.5 Euro Bruto**

**Kualifikimi : Diplomë Universitare - Fakulteti i Bujqësisë**

### **Detyrat e punës:**

1. Harton planet për mbrojtjen e bimëve furagjere dhe ngritjen e fushave të reja me këto bimë
2. Bën grumbullimin e të dhënave lidhur me gjendjen e bujqësisë dhe agrokulturës së komunës
3. Bën analizat e gjendjes së tanishme të fermerëve të vegjël dhe të mesëm për nevojat e tyre dhe mënyren si të ndihmohen
4. Ndihmon drejtorin në të gjitha punët nga përgjegjësia e shërbimit
5. Kryen hulumtime dhe analiza mbi çështjet e bujqësisë si dhe kryen detyra të tjera në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrësi



#### **4. Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale**

**Titulli i vendit të punës: Zyrtar për Shërbime Sociale - Dy (2) pozita**

**Paga: 362.5 Euro Bruto**

**Kualifikimi : Diplomë universitare, në fushë të punës sociale, psikologjisë, sociologjisë, drejtësisë, pedagogjisë ose në ndonjë lëmi tjetër të lidhur ngushtë me shërbimet sociale dhe familjare**

##### **Detyrat kryesore:**

1. Harton dhe zhvillon planet e punës në pajtim me mbikëqyrësin për zbatimin e detyrave të përcaktuara në bazë të objektivave të njësisë dhe jep rekomandime lidhur me realizimin e këtyre objektivave;
2. Analizon dhe vlerëson proceset dhe procedurat brendshme dhe rekomandon ndryshime dhe përmirësime me qëllim të rritjes së efikasitetit dhe cilësisë së punës;
3. Trajton rastet dhe përgatitë raport për gjykatën për heqjen e zotësisë së veprimit të personave të paaftë për të vepruar;
4. Trajton mbrojtjen e fëmijëve pa kujdes prindor, birësimin, kujdestarin dhe strehimin e përkohshëm familjar;
5. Trajton rastet e fëmijëve me sjellje asociale dhe delikuate, rastet e angazhimit të fëmijëve në punët e rënda dhe të lënies pa kujdes
6. Monitoron rastet e dhunës në familje dhe angazhohet në përmirësimin e marrëdhënieve bashkëshortore dhe bënë propozimin për besimin e fëmijëve në raste të shkurorëzimit të prindërve dhe përcjell realizimin e kontakteve
7. Përkujdeset edhe për kategoritë tjera të personave me nevojë, të moshuarit, fëmijët me aftësi të kufizuara të përhershme, personave që konsumojnë substanca narkotike, alkoolike etj
8. Kryen edhe detyra tjetër në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrësi

## INFORMATË PËR TË GJITHË APLIKANTËT

### Kandidatët e interesuar duhet të paraqesin:

- CV
- Kopjen e leternjoftimit
- Certifikaten qe ndaj tij nuk janë duke u zhvilluar hetime
- Kopjen e Dokumentacionit për kualifikim

### Data e shpalljes : 26.06.2020 deri më 30.06.2020

Komuna e Podujevës ofron mundësi të barabarta punësimi për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Konkursi mbetet i hapur **5 ditë** nga data e shpalljes në mjetet e informimit publik dhe në tabelën e shpalljeve

Fletëaplikacionet merren në Qendrën e Shërbimit për Qytetarë, në ndërtesën e Kuvendit të Komunës.

Kërkesat me dokumente të kompletuara dorëzohen në Qendrën e Shërbimit për Qytetarë.



Nënkryetari i Komunës  
Nexhmi Rudari

*Nexhmi Rudari*